



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AVOKATI I POPULLIT**  
**Seksioni i Veçantë**

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

**Nr. K2/I56-2 Prot.**  
**Nr. Dok. 202101611/2**

**Tiranë 21/12/2021**

**Lënda :** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen dhe dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve.*

**MINISTRIT TË DREJTËSISË**  
**Tiranë**

***I nderuar Zoti Manja!***

Avokati i Popullit gjatë veprimtarisë së tij në kuadër të përmbushjes së misionit kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të shtetasve ka konstatuar se, ndonëse ka kaluar afati ligjor i parashikuar në nenin 91 të ligjit të ri nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", ende nuk është miratuar Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, e parashikuar në nenin 60/3 të këtij ligji dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur (KDPM).

Referuar nenit 91 të ligjit nr. 81/2020, përgatitja dhe miratimi i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve duhet të ishte bërë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi i këtij ligji. Sqarojmë se ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 23.07.2020 dhe ka hyrë në fuqi në datën 08.08.2020. Pra, afati 6 muaj është plotësuar në datën 08.02.2021.

Dispozitat e KDPM-së dhe të ligjit nr. 81/2020 ndërmjet të tjerave parashikojnë që rregullat e hollësishme të procesit disiplinor dhe të aplikimit e zbatimit të masave disiplinore ndaj të burgosurve dhe veçanërisht e të burgosurve të mitur, përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Ky detyrim nga ana tjetër mbetet i pa zbatuar që nga viti 2018 për KDPM.

Pavarësisht faktit që për masat disiplinore, rregullat e dhënies së tyre të burgosurve të mitur, ligji referon zbatimin e KDPM-së, i cili është një akt normativ më i lartë në hierarki

se sa ligjet dhe aktet nënligjore, në vlerësojmë se miratimi i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve është jo vetëm detyrim ligjor por edhe i domosdoshëm. Kjo për faktin se sipas KDPM-së dhe ligjit nr. 81/2020, rregullat e hollësishme për këtë kategori personash dhe në këtë fushë duhen parashikuar në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve. Sjellim në vëmendje gjithashtu se në punën rutinore të përditshme akti me të cilin janë në kontakt të vazhdueshëm punonjësit e Policisë së Burgjeve është Rregullorja dhe jo me KDPM-ja. Po kështu, e nevojshme është që ndryshimet përkatëse duhet të pasqyrohen menjëherë edhe në rregulloren e brendshme të çdo IEVP-je dhe në mënyrë të veçantë të IEVP Kavajë në të cilin janë akomoduar e trajtohen të burgosurit e mitur.

Më konkretisht, sa i përket procesit disiplinor, në nenin 60 të ligjit nr. 81/2020 “Rregullat e disiplinës” parashikohet si vijon:

*1. Rregullat e disiplinës zbatohen në mënyrë që të stimulojnë ndjenjën e përgjegjësisë dhe aftësinë e vetëkontrollit të të burgosurit. Ato hartohen në përshtatje me gjininë, moshën, gjendjen fizike, psikike e psikologjike të tij.*

*2. Për të burgosurit e mitur, të burgosurit e diagnostikuar me çrregullime të shëndetit mendor, të burgosurit që kanë pasur përvoja të dhunës fizike, psikologjike ose të abuzimit seksual, zbatohet një regjim disiplinor lehtësues në përputhje me nevojat e tyre.*

**3. Rregullat e regjimit disiplinor lehtësues dhe procedurat për zbatimin e tij përcaktohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.**

Në nenin 61 “Rregullat e zbatimit të masave disiplinore” të ligjit të cituar më sipër, pika 5 parashikohet se:

*“Në rastin e të burgosurve të mitur, llojet e masave disiplinore dhe kufijtë e zbatimit të tyre jepen në përputhje me parashikimet e KDPM-së.”*

Ndërsa referuar KDPM-së, miratuar me ligjin nr. 37/2017 rezulton se në nenin 111 “Rregulla të posaçme të ekzekutimit të vendimit me burgim” parashikohet se:

*“1. Në funksion të interesave të posaçëm të mbrojtjes dhe kujdesit për të miturit merren masa të veçanta, me të cilat garantohen standardet e përcaktuara nga Kushtetuta, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara, si dhe nga dispozitat e këtij Kodi.*

***2. Në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve parashikohen në mënyrë të veçantë rregulla për:***

***a) strukturën dhe funksionimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të mitur;***

***b) planifikimin individual të ekzekutimit të dënimit për të mitur;***

***c) zbatimin e formave të stimujve dhe masave të tjera për të dënuarit e mitur;***

***ç) dhënien e masave disiplinore ndaj të dënuarve të mitur;***

- d) procedurën për shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave të të dënuarve të mitur;*
- dh) organizimin e procesit të rehabilitimit të të dënuarve të mitur;*
- e) kushtet për zbatimin e masave të sigurisë dhe përdorimin e mjeteve të posaçme për të dënuarit e mitur;*
- ë) funksionimin e regjistrave dhe fashikujve personalë të të dënuarve të mitur;*
- f) mbikëqyrjen dhe kontrollin vizual dhe/ose elektronik të të dënuarve të mitur;*
- g) kushtet më të detajuara për ekzekutimin e vendimit me burgim për të dënuarit e mitur.*

Në nenin 125 “Kufijtë e zbatimit të masave disiplinore” të KDPM-së parashikohet se:

*1. Administrata e institucionit të vuajtjes së dënimit për të mitur është e autorizuar të përdorë masa disiplinore ndaj të miturit në rastin e një shkeljeje disiplinore të kryer prej tij.*

*2. Masat disiplinore duhet të jenë zgjedhja e fundit që mund të merret për sjelljen e të miturit.*

*3. Puna nuk mund të jetë një masë disiplinore.*

*4. Masat disiplinore të marra nuk duhet të sjellin shkeljen apo cenimin e dinjitetit të të miturit, trajtimin e egër, çnjerëzor, degradues apo dëmtimin e shëndetit të tij fizik ose mendor. Ndalohet përdorimi si masë disiplinore i veprimeve të mëposhtme, por pa u kufizuar në këto raste:*

- a) dënim fizik ose trupor;*
- b) vendosje në një vend izolimi;*
- c) heqje ose kufizim i ushqimit;*
- ç) heqje ose kufizim i kujdesit shëndetësor;*
- d) ndalim ose kufizim i takimeve me familjarët ose kontakteve me ta.*

***5. Rregulla të posaçme për zbatimin e këtij neni parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.***

Sipas nenit 126 “Llojet e masave disiplinore” pika 2 të këtij kodi, ***“Ndalohet që i mituri gjatë vuajtjes së dënimit të vendoset në mjedise të veçuara/të izoluar.”***

Ndërsa në nenin 127 të KDPM-së “Procedurat për dhënien e masave disiplinore”, pika 4 parashikohet se:

***“Rregulla të posaçme për zbatimin e këtij neni parashikohen në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.”***

Në vlerësimin tonë, vonesa e përgatitjes dhe miratimit të Rregullores së re të Përgjithshme të Burgjeve ka sjellë si pasojë edhe mosrespektimin dhe cenimin e të drejtave të garantuara të të burgosurve dhe në veçanti të atyre të mitur. Një rast i tillë konkret i cili është konstatuar nga strukturat e institucionit tonë ka ndodhur në IEVP Kavajë ndaj të

paraburgosurit Xh.S. në datën 01.03.2021 kur në orët e natës nga Forcat Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, është ushtruar dy herë kontroll. Kontrolli është bërë me arsyetimin e pa kuptimtë dhe të pa bazuar se “në datën 07.03.2021 i paraburgosuri mbushte moshën 18 vjeç dhe në bazë të ligjit, duhet të transferohej në një I EVP tjetër”.

Sipas nenit 54/1 të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, *i burgosuri i nënshtrohet kontrollit personal në çdo rast të hyrjes ose të daljes nga institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale dhe në rast kur ka dyshime të arsyeshme për mbajtjen e sendeve të ndaluara*. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, në momentin që ai do të transferohej në një I EVP tjetër për shkak të mbushjes së moshës madhore, atij do t’i bëhej kontroll i imtësishëm si në institucionin nga i cili do të largohej, ashtu edhe në institucionin ku do të tranferohej.

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe këqyrja e pamjeve filmike të sistemit të monitorimit të I EVP Kavajë të regjistruara në datën 01.03.2021, i bërë nga ana jonë, rezultoi se në këtë datë, në orën 18:00, rreth 10 punonjës të Forcave Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve kanë hyrë në ambientet e sektorit nr. 1 të këtij institucioni. Ata kanë ushtruar kontroll për 3 minuta ndaj të paraburgosurve të mitur që ndodheshin në hollin e këtij sektori, ndërmjet të cilëve ishte edhe shtetasi Xh.S.. Në orën 22:00 në koridorin e sektorit 1 të këtij institucioni kanë hyrë përsëri Forcat Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe kanë ushtruar kontroll në të gjitha dhomat e këtij sektori për sende të ndaluara. Ata kanë hyrë edhe në dhomën nr. 1 ku ndodhej i paraburgosuri Xh.S. dhe pas pak sekondash e kanë shoqëruar atë në dhomën e veçimit, ku e kanë lënë rreth 3 orë.

Në vlerësimin tonë, kontrolli i ushtruar të burgosurit të mitur Xh.S. në këtë rast është i pa bazuar në ligj. Ndonëse ndaj tij nuk u ndoq ndonjë procedurë disiplinore dhe nuk është marrë ndonjë vendim nga Komisioni i Disiplinës së I EVP Kavajë, në fakt ai është ndëshkuar me një nga masat disiplinore të parashikuara për të burgosurit madhorë dhe jo për të burgosurit e mitur.

Theksojmë se, sipas dispozitave të KDPM-së, të cilat i cituam më sipër, një masë e tillë disiplinore jo vetëm që nuk është parashikuar në llojet e masave disiplinore që zbatohen ndaj të burgosurve të mitur, por ndërkohë vendosja e tyre në mjedise veçimi është e ndaluar në mënyrë të posaçme dhe respektivisht nga nenet 125/4/b dhe 126/2 të këtij Kodi. Sqarojmë se pavarësisht faktit që sipas shënimeve të pasqyruara në “Regjistrin e ngjarjeve të rënda për të dënuarit” në I EVP Kavajë, rezulton se i paraburgosuri Xh.S. është dërguar në dhomën e observimit “për arsye sigurie”, por nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit u konstatua se në asnjë dokument apo informacion nuk pasqyrohet se çfarë rreziku i kanosej atij apo institucionit prej tij. Ky veprim nuk ka asnjë bazë ligjore dhe për rrjedhojë nuk mund të ketë asnjë lloj justifikimi dhe në asnjë rrethanë aplikimi i kësaj mase disiplinore të rëndë dhe për më tepër të ndaluar nga ligji. Edhe vendosja e tij në ambientin e observimit përbën një ndëshkim, sepse edhe ky ambient nuk ndryshon në

thelb nga ai i veçimit dhe aq më tepër që është zbatuar në orët e vona të natës ndaj një të mituri, i cili për më tepër ka shfaqur edhe çrregullime të sjelljes muajt e parë të vitit 2021.

Ky qëndrim përbën një shkelje të rëndë të të drejtave ligjore të një burgosuri të mitur të garantuar nga KDPM-ja dhe ligji nr. 81/2020 duke i shkaktuar pasoja dhe trauma të rënda, me afat të gjatë dhe të pariparueshme psiko-sociale këtij shtetasi. Veprimi i kundërligjshëm i kryer nga Forcat Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për veçimin e të paraburgosurit të mitur Xh.S., analizimi, nxjerrja e përgjegjësive ligjore dhe ndëshkimi disiplinor i tyre, trajnimi i punonjësve të policisë për mënyrën e sjelljes gjatë ushtrimit të kontrolleve, si dhe përgjithësimi i këtij rasti do të jetë objekt i një rekomandimi tjetër që do të bëhet nga institucioni ynë.

Përveç sa më sipër, ne vlerësojmë se mos miratimi i Rregullores së re të Përgjithshme të Burgjeve krijon premisa për cënimin e të drejtave të të burgosurve nga administrata e IEVP-ve.

Ndodhur në këto rrethana, në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor *në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”,* dhe në nenin 21/b, të ligjit nr. 8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit kryen këto veprime:*  
*b. paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive;”*

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë për përgatitjen e Rregullores së re të Përgjithshme të Burgjeve në bazë e për zbatimin e ligjit nr. 81/2020 dhe të KDPM-së.
2. Dërgimin e projekt Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve për marrje mendimi institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe të drejtave të fëmijëve.
3. Marrjen e masave të nevojshme për dërgimin për miratim të kësaj Rregulloreje në Këshillin e Ministrave.
4. Marrjen e masave të nevojshme nga IEVP-të që menjëherë pas miratimit të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve të përgatisin e miratojnë rregulloren e brendshme të këtyre institucioneve.
5. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e vonësës së përgatitjes të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe nxjerrjen e përgjegjësive të strukturave dhe personave

përkatës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të ktheni përgjigje brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda BALLANCA**